

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: "SAMIRE OSMANI" B.I. adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi – U.d. Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 29.05.2019, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "SAMIRE OSMANI" B.I. adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: 623-19-3485-2-2-1, Nr i brendshëm: 623-19-024-2-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e parashtruar nga Operatorit Ekonomik: "SAMIRE OSMANI" B.I. adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: 623-19-3485-2-2-1, Nr i brendshëm: 623-19-024-2-2-1, i shpallur nga Autoriteti Kontraktues: **Komunae Rahovecit**.
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54*, andaj Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit vazhdon ma tutje me aktivitetin e prokurimit siq është parpar në DT dhe Njoftimin për Kontratë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
 U.D.Menaxher i Zyres se Prokurimit
 Komuna e Rahovecit

